

Një rrugëtim reflektues me
Politika si ide
e Valentina Leskaj

Analiza, refleksione, opinione

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2025

Botuese: Irena Toçi

Përgatiti për shtyp: Eris Rusi

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike: Adriana Matraku

Kopertina: Anisa Kaltanji

ISBN 9789928960221

© AUTORJA *dhe* BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet pa leje paraprake.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja” nr. 71, Tiranë 1023.

Kutia Postare 1420

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al/>

*Një prej çelësave drejt tolerancës
është ndërgjegjësimi që ne, hera-herës,
jemi ata, të tjerët, dhe që ata janë hera-herës ne,
me po aq të meta e kufizime të padurueshme,
e megjithatë, prapëseprapë të denjë për respekt
ashtu si edhe ne...*

CLAUDIO MAGRIS

DY FJALË LEXUESIT

Në çdo libër që lind, ka një ngulmim për të mbijetuar në kohë, një dëshirë për të thënë diçka thelbësore mbi njeriun dhe botën. Si botuese, kam besuar gjithnjë se libri është një formë e lartë përgjegjësie: një akt që shkon përtej tregut e përtej modës së ditës, drejt asaj që mbetet. Nuk e kam parë kurrë librin si një objekt të heshtur, por si një qenie që rritet, që kërkon dritë dhe frymë, lexuesit e vet.

Prej tridhjetë vitesh kjo ka qenë motoja e shtëpisë botuese “Toena”: të ndihmojë fjalën të marrë formë, mendimin të gjejë shtëpi dhe autorin të dëgjohet. Kështu, kur mora përsipër të botoja librin “Politika si ide” të Valentina Leskajt, e dija që kisha përpara një vepër që do të kalonte kufijtë e zakonshëm të një libri politik. Ishte një libër që vinte nga përvoja, por edhe nga ndërgjegjja; nga një grua që kishte përfaqësuar me dinjitet një brez të tërë të politikës shqiptare, por që kishte mbetur, mbi të gjitha, qytetare e ndjeshme ndaj jetës, shoqërisë dhe vendit tonë.

Për mua, si botuese, ky ishte një takim i rëndësishëm me një mendje të kthjellët, me një zë që fliste për përgjegjësinë e pushtetit, për rolin e gruas, për etikën e politikës dhe për kulturën e debatit. Pas botimit të tij në shqip, “Politika si ide” nisi të shpaloste jetën e vet në universitete, në media, në debate publike dhe u prit si një reflektim i thellë mbi tranzicionin, demokracinë dhe sfidat e një shoqërie që kërkon rrugën e vet drejt modernitetit.

Vlerësimet e para që mori libri nga studiues, gazetarë dhe personalitete publike e dëshmuuan këtë: nga analiza e thellë e Selami Xhepës mbi etikën dhe pjekurinë demokratike, te reflektimi i Alfred Pezës për politikën si busull njerëzore; nga këndvështrimet sociologjike e kulturore të Kosta Barjabës, Ilir Kalemajt, Arta Marku Qëndros e Odise Kotes, te reflektimet më personale, profesionale e njerëzore të Agim Baçit, Majlinda Ramës e shumë të tjerëve që e panë librin si një tekst me vlera të qëndrueshme për shoqërinë shqiptare.

Çdo shkrim, çdo analizë, çdo fjalim që u mbajt për këtë libër, më ngjante si një copëz mozaiku që duhej ruajtur për t’u parë e lexuar bashkë. Kështu lindi ideja e këtij botimi, për ta bërë të prekshme gjithë këtë jehonë, për ta kthyer reagimin në kujtesë dhe fjalën në dëshmi.

Ndaj kjo vepër që sheh sot dritën e botimit është, në thelb, një libër për një libër. Një rrugëtim

përmes mendimeve që lindën prej “Politikës si ide”, por që tashmë e tejkalojnë atë, duke ndërtuar një reflektim të përbashkët mbi politikën, qytetarinë dhe mbi mënyrën se si një shoqëri e dalë nga regjimi diktatorial mund të ruajë dinjitetin e vet përballë sfidave të mëdha.

Në këtë kuptim, ky botim është edhe një homazh për mendimin e lirë, për fuqinë e fjalës, për vlerën e debatit të civilizuar dhe për shpresën se politika mund të jetë përsëri një hapësirë etike, një vend ku idetë dhe njerëzit takohen për të ndërtuar më shumë se pushtet: për të ndërtuar mirëkuptim.

Një nga momentet më domethënëse të jetës së këtij libri ishte përkthimi i tij në italisht nga studiuesja Ida Xoxa dhe botimi nga Shtëpia Botuese “Bonanno”, e cila “ka qenë pika e referencës për rilindjen italiane”¹. Ishte një privilegj dhe një emocion i rrallë ta shihje librin e Valentina Leskajt të prezantohej në Senatin Italian, në një nga institucionet më të respektuara të demokracisë europiane.

Në atë sallë, ku janë mbajtur fjalime që kanë bërë histori, u dëgjuan zëra që folën për Shqipërinë me respekt dhe vlerësim. Senatorja Gisella Naturale e quajti librin “një manual për të kuptuar filozofinë e të bërit politikë”, ndërsa deputeti Arnaldo Lomuti e lexoi si një rrëfim mbi demokracinë, gjuhën e

1. Mauro Bonanno, *Fjala* ne Senatin Italian.

politikës dhe miqësinë mes dy popujve. Botuesi italian Mauro Bonanno foli për Shqipërinë si për një “vend që ndërton ëndrrën e vet”, ndërsa ambasadorja Anila Bitri e pa këtë ngjarje si një dëshmi të forcës së kulturës shqiptare për të dialoguar me Europën.

Ishte një ditë që na kujtoi se librat mund të ndërtojnë ura që diplomacia shpesh i harron: ura midis popujve, kulturave dhe mënyrave të të menduarit.

Për këtë arsye, fjalët e mbajtura nga këta senatorë i japin peshë e ndriçim gjithë kësaj përvoje që shkon përtej një promovimi letrar. Prania e zërave italianë, përkrah autorëve e studiuesve shqiptarë, i jep këtij libri një dimension të gjerë ndërkulturor, ku bashkëjetojnë mirënjohja, reflektimi dhe respekti i ndërsjellë. Kjo përbën edhe vetë frymën e bashkëpunimit që “Toena” ka mbajtur gjithmonë gjallë me partnerë europianë, sepse kultura është ura më e qëndrueshme mes popujve.

Renditja e shkrimeve në këtë libër është bërë me kujdes kronologjik, duke ndjekur udhëtimin që “Politika si ide” ka bërë në hapësirën publike, nga momenti i botimit deri tek jehona që mori në arenën ndërkombëtare. Kjo renditje nuk është vetëm formale: ajo ndjek ritmin e vet të brendshëm, si një udhëtim që nisët në Tiranë e përfundon në Romë, por që në thelb flet për të njëjtën gjë - për fuqinë e një ideje, kur ajo mbështetet mbi integritetin e njeriut që e mban.

Në këtë udhëtim, autorët nuk janë vetëm komentues të një libri, por dëshmitarë të një kohe, të një epoke politike dhe intelektuale që po kërkon të rigjejë vlerat themelore të shoqërisë. Ata vijnë nga fusha të ndryshme, nga ekonomia, politika, filozofia, gazetaria, diplomacia, arti, por në fjalët e tyre gërshetohet një ndjenjë e përbashkët: respekti për mendimin, për etikën e debatit dhe për dinjitetin e fjalës publike.

Në fund, mbetet mirënjohja: për autorët që kanë folur me pasion dhe kulturë; për Valentina Leskajn, që i ka kthyer idetë e përvojën e vet në analiza e reflektim e madje edhe frymëzim; për botuesin italian Mauro Bonanno dhe për të gjithë ata që e bënë të mundur këtë udhëtim të bukur të fjalës. Sepse, pa dyshim, librat që lindin nga ide, nga përkushtimi dhe nga dashuria për njeriun, janë ata që vazhdojnë të jetojnë më gjatë se koha kur u shkruan dhe dolën për herë të parë në qarkullim.

IRENA TOÇI

Botuese, Shtëpia botuese TOENA

PROF. ASSOC. DR. SELAMI XHEPA

President, Universiteti European i Tiranës

“Politika si ide”

në këndvështrimin e Valentina Leskaj

[...Përgjegjshmëria, llogaridhënia dhe “checks and balance” në ndërtimin e strukturës së qeverisjes së vendit, janë kritike që qytetarët të ruajnë besimin te demokracia, tek pushteti i votës së tyre ...]

“Politika si ide” i znj. Valentina Leskaj, është një narrativë e tre dekadave të eksperiencës personale politike dhe shoqërisë civile, një rrëfenjë e një tranzicioni epokal të shoqërisë njerëzore në tërësi, dhe të vendit tonë, Shqipërisë, në veçanti. Teksa e kam lexuar gjatë përgatitjes për botim, jam zbavitur prej larmisë së tematikave të trajtuara; zhvendosjeve në kohë dhe hapësirë që krijohen në secilën prej tyre; personalizimi i ideve tek individë të caktuar të shquar të fushave, e njëherësh abstraksioni si teorizim mbi fenomenet; prekja emocionale që të

krijon trajtimi i grupeve vulnerabël, dhe ftohtësia që ruhet në raport me dështimet konsekuente të politikave publike; ecjes kritike në linjën e përfaqësimit të saj ideologjik, përballë dështimeve në artikulumin e politikave publike nga të dyja kahet e spektrit politik shqiptar.

Ky libër nis si një tekst i shkruar për gruan, lëvizjen feministe dhe të drejtat e gruas në shoqëri. Them se nuk mund të kishte nisje më të duhur për një femër që edhe vetë veprimtarinë e saj, siç dëshmohet përgjatë faqeve të të gjithë librit, e ka kaluar në kauza në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Angazhimi politik dhe aksioni publik qytetar lidhen pazgjidhshmërisht me zbulimin e forcës së gruas dhe vërtetimin e tezës se, shoqëritë që kanë ditur të angazhojnë gruan në punët e vendit, ia kanë dalë të ndërtojnë familje të shëndetshme dhe shoqëri të shëndetshme. Ndërsa shoqëria njerëzore ka kaluar nga epoka e matriarkatit tek ajo e patriarkatit, sot po predikojmë të ndërtojmë një shoqëri që ruan një rol të barabartë për të dy anët e ekuacionit të zhvillimit, të burrit dhe gruas. Vendet që ia kanë dalë të gjejnë më mirë këtë balancë, janë edhe vendet me nivelet më të larta të kënaqësisë njerëzore dhe harmonisë sociale. Znj. Leskaj e ka përcjellë mesazhin e saj përmes kontributeve të konferencave shkencore ndërkombëtare, duke qenë dhe vetë protagoniste.

Një temë me shumë interes që trajtohet në libër është ajo e pjekurisë demokratike të shoqërisë. Si një shoqëri me trashëgimi deficitare në fushën e demokracisë, si një vend ku dhe eksperimenti komunist u zbatua në formën e vet më ortodokse ekstreme, nuk mund të pritej që transpozimi i sistemit të ri të vinte pa probleme dhe në mënyrë të butë. Sistemet nuk janë si direktivat e BE-së që mund të transpozohen nga departamentet juridike, sepse demokracia është mënyrë organizimi dhe ideal shoqëror që bazohet në respektimin e parimeve fundamentale që e bëjnë atë një sistem të besueshëm nga e gjithë shoqëria.

Përgjegjshmëria, llogaridhënia dhe “*checks and balance*” në ndërtimin e strukturës së qeverisjes së vendit, janë kritike që qytetarët të ruajnë besimin tek demokracia, tek pushteti i votës së tyre. Fatkeqësisht, siç e pohon dhe autorja në libër, nuk ia kemi dalë të ndërtojmë një demokraci funksionale, ku shteti ligjor, rendi dhe ligji funksionojnë sipas parametrave të një shoqërie moderne europiane. Personalizimi i pushteteve, por dhe i segmenteve të rëndësishme të jetës ekonomike, kaq i dukshëm në kontekstin shqiptar, bie në kontrast të thellë me natyrën impersonale të institucioneve qeverisëse dhe transaksioneve në ekonomi, që duhet të ekzistojnë në një shoqëri demokratike dhe tregut të lirë. Deficiti demokratik është një arsye madhore e lodhjes dhe

zhgënjimeve të shoqërive që dolën nga sistemet totalitare, të sjella mjeshtërisht nga autorë të njohur sot, më së fundmi edhe nga shkencëtari politik Ivan Krastev me librin e tij me bashkautorësi me Stephen Holmes, *“The Light that Failed”*. Kjo është një temë qendrore edhe e këtij libri dhe mendoj se përbën një kontribut në trajtimin e këtij problemi specifikisht në kontekstin shqiptar.

Konflikti politik si mungesë idesh dhe roli i medias si amplifikues i së keqes dhe konfliktit, mund të konsiderohen si një prej faktorëve që kanë mbjellë dëshpërim tek publiku dhe kanë prodhuar këto zhgënjime të thella tek e gjithë klasa politike, e që mund të shndërrohen në një mosbesim tek vetë sistemi. Gjuhën e urrejtjes që e ndesh në politikë - që nga Parlamenti dhe në retorikën e përditshme politike - autorja me të drejtë e sheh si: “...një problem i madh për vet moralin e shoqërisë, e cila bëhet e rrezikshme sidomos kur ndikon te të rinjtë duke nxitur një kulturë të dëmshme për brezat dhe për fat të keq kjo situatë po lë gjurmë”.

Dhuna verbale dhe konfliktualiteti në shoqërinë e sotme, nuk janë një problem thjesht shqiptar, por një çështje shqetësuese që merr shumë mprehtësi në kushtet e përparimit të sotëm teknologjik. Populizmi në politikë që vitet e fundit është një fenomen kaq shumë i përhapur në botë, i ka dhënë më shumë zë grupeve ekstremiste dhe votuesi “medianë” është pa zë.

Raporti delikat midis lirisë së fjalës, fuqisë së teknologjisë për të depërtuar përmes rrjeteve sociale në mënyrë personale tek gjithë popullata përdoruese, efektivisht tek gjithsecili prej nesh, dhe rregullimit të këtij ekuilibri, kanë marrë së fundmi trajtat e një konflikti të madh mes politikës, si ushtruese e rregullimit dhe medias sociale (dhe shoqërisë) si promotore të lirisë së shprehjes. Raporti i teknologjisë dhe rregullimit është gjithnjë problematik, sidomos kur ndryshimet janë paradigmale.

Ndasitë politike, siç e thotë autorja me të drejtë në libër, vazhdojnë të mbeten të thella. Fakti që ne biem dakord pa dallime politike për çështje të debatit global, të themi me përkufizimin e antisemitizmit, por nuk biem dakord me dënimin e krimeve të komunizmit, janë një tregues i faktit se e shkuara dhe dallimet në raport me të, kanë rrënjë shumë të thella. Mendoj se në një kuptim, ndryshimi i vërtetë social në Shqipëri do jetë realizuar kur shoqëria të jetë gjakftohtë në gjykimin e historisë së shkuar, duke i vendosur palët në histori në ekuidistancë.

E tillë është edhe ndarja në të majtë dhe të djathtë; ajo nuk është një çështje e raportit të individit me pasurinë apo pozicionin e tij në shoqëri, por çështje e raportit të individit me lirinë, e mënyrës se si dikush e percepton raportin individ-shoqëri. Dhe kjo do të thotë se të qenit i pasur nuk të bën domosdoshmërisht të djathtë, ashtu sikurse të

qenit me të ardhura ekonomike modeste, nuk të bën domsdoshmërisht të majtë. Për më shumë, në një botë që po rend kaq fort pas materializmit, rikthimi drejt metafizikës, drejt idesë, drejt shpirtit njerëzor, po prek gjithnjë e më shumë individë, përfshi dhe *tycoon* të mëdhenj të kapitalit. *Business Round Table*, për shembull, është një iniciativë e një grupi kompanish shumëkombëshe ndër më të mëdhatë amerikane, që po promovon një ndryshim të rëndësishëm në natyrën e sistemit kapitalist, një zhvendosje nga kapitalizmi aksionar, pra korporatës që punon për pronarët, drejt kapitalizmit të aktorëve, korporatës që balancon më mirë interesat si të pronarëve, ashtu dhe të punëtorëve, mjedisit, komunitetit dhe shoqërisë në tërësi.

Fatkeqësisht, siç e thotë me të drejtë znj. Leskaj në libër, ideologjitë e majta dhe të djathta në Shqipëri nuk kanë pasur pasues konsekuent nga asnjëri krah politik. Dhe ky nuk është një problem që lidhet me natyrën ortodokse të politikave të tranzicionit, të cilat mund të kuptohen për dekadën e parë të viteve '90, por janë të pajustificueshme më vonë, por siç e thotë autorja, janë pjesë e pragmatizmit elektoral. Në veçanti, sot kur në gjithë botën ka nisur një debat global për një reformim të sistemit kapitalist, për një ribalancim më të mirë të sistemit që të punojë edhe në mbrojtje të punëtorëve po aq sa dhe të sipërmarrësve, tema e modelit të ri ekonomik

në Shqipëri shihet si një çështje thjesht teknike, se nga do gjenerohet rritja ekonomike; si një debat pozitivist dhe jo normativ.

Zhvillimet sociale dhe demografike janë dhe mbyllja e librit. Që të dyja këto tema vijnë në një kontekst shqetësues, të problemeve që ato krijojnë në aspektin ekonomik dhe social në vitet që do të vijnë. Kjo temë të cilën autorja e zhvendos pas në kohë që në vitet '70, me raportin e famshëm të Klubit të Romës dhe paqëndrueshmërinë e modelit ekonomik përballë presioneve demografike, sot vjen në një trajtë tjetër; atë të një popullsie të plakur dhe rënie të lindshmërisë, të cilat do të prodhojnë sfida të vërteta serioze për vendet që do të ndikohen. Këtu bën pjesë dhe Shqipëria, ku vijat e grafikut të raportit midis fashës së popullsisë së re dhe asaj të plakur do të priten duke filluar nga viti 2023. Për pasojë, tregu i punës dhe gjithë tregjet e tjera do të ndikohen në një mënyrë të thellë dhe do të sjellin pasoja gjithnjë e më të forta në shoqëri.

Znj. Leskaj jep përmes këtij libri një kontribut të rëndësishëm në këtë larmi temash dhe sfidash. Duke qenë edhe një rrugëtim në ato se çfarë ka ndodhur në këto tre dekada tranzicioni, libri ka një vlerë të shtuar edhe si një libër reference për studiuesit e këtyre fushave. Libri ka përfutur gjithashtu jo vetëm nga dijet dhe angazhimet politike të autores, por dhe nga pasuria e eksperiencave personale, duke e bërë

atë një libër të shkruar përgjatë gjithë kësaj kohe dhe të pasuruar përmes një morie episodesh interesante.

Gazeta Liberale, Dosja AL etj., 19 prill 2021

PIRO MISHA

**Studiues, përkthyes, Drejtor i Bibliotekës
Kombëtare të Shqipërisë**

“Politika si ide” dhe përvoja komplekse e tranzicionit shqiptar

[...Mendoj se një ndër vlerat e mëdha të këtij libri është se, veç kërkësisë së natyrshme që sjell gjithnjë mundësia që të jep një vepër që të lejon të shohësh sado pak atë që ndodh pas kuintave, është kontributi që libri “Politika si ide” sjell për të nxitur një debat mjaft të dobishëm për shumë prej atyre çështjeve që ai trajton...]

Kur më dha Vali dorëshkrimin e librit të saj për ta lexuar, siç më ndodh gjithmonë në kësi rastesh, fillimisht pata një lloj hezitimi, sepse nga përvoja e gjatë si botues e di se, kur dikush të jep një libër ta lexosh, ai natyrisht që pret t’i thuash ca fjalë (mundësisht të mira) pasi e ke lexuar. Po puna është që unë e kam gati të pamundur ta lavdëroj një libër

po qe se s'më ka pëlqyer vërtet, shprehi kjo ndoshta e krijuar gjatë viteve kur si botues, çdo fjalë e mirë që mund të thosha për një libër, nënkuptonte vetiu detyrimin për ta botuar atë.

Fatmirësisht, në rastin e librit të Valentina Leskaj ky problem nuk ekziston. Madje, në rastin e librit “Politika si ide” që Vali sapo ka botuar, mund të them se unë s’kam asnjë problem ta them fjalën e fundit të parën, i vetëdijshëm se kështu në njëfarë mënyre, bëhem garant para të gjithë jush që nuk keni pasur mundësinë për të lexuar librin, se ky është një libër që ia vlen ta merrni e ta lexoni. Po, e them këtë pa asnjë hezitim: libri “Politika si ide” është një ndër ata libra që duhen lexuar.

Të jem i singertë, gjëja e parë që më erdhi ndër mend kur po e lexoja këtë libër, është se mes kësaj çoroditje e kakofonie shurdhuese që ne po jetojmë, mes asaj morie pseudo-protagonistësh që rëndom mbushin faqet e gazetave, apo ulërasin gati përnatë nëpër studiot televizive, kishim harruar sa shumë nevojë kemi të dëgjojmë zërin e atyre që, me përvojën dhe urtësinë e tyre, kanë ç’të na thonë; të dëgjojmë zërin e atyre që kanë aftësinë të na ndihmojnë për të kuptuar më mirë të shkuarën, të sotmen, apo dhe të ardhmen që na pret, duke na ndihmuar të kuptojmë se ç’është e bërë mirë, ku është gabuar dhe, ç’është më e rëndësishmja, ç’duhet bërë për të përballuar sfidat që na presin përpara.

Ky libër është padyshim produkt i një pune të gjatë, i një procesi të gjatë reflektimi. Kur e lexon, s'është aspak e vështirë të kuptosh se ky libër kaq kompleks nuk është produkt i një frymëzimi të çastit, por rezultat i një përvoje e reflektimi të gjatë të një personi që është i bindur se ka shumë për të na thënë. Ishte pikërisht kjo përshtypja e parë që unë pata teksa po e lexoja librin e Vali Leskajt. Në një moment të caktuar të jetës së saj, pas një përvoje të gjatë jetësore si një aktiviste e shquar e shoqërisë civile; protagoniste në nivele e larta të politikës dhe të qeverisjes, pas një përvoje të vyer të fituar nga kontaktet e saj të shumta ndërkombëtare, Valentina Leskaj gjykoi se kishte ç'të thoshte me vlerë dhe për të tjerët.

Valentina Leskaj duket që është e bindur dhe ka ç'të thotë në cilësinë jo thjesht të një spektatoreje nga jashtë të jetës sonë politike e sociale, po ashtu në cilësinë e një prej protagonistëve me rëndësi në jetë politike, partiake, e shoqërore. Kjo përbën një ndër avantazhet e rëndësishme të këtij libri, që mund të thuhet se e bën atë krejt të veçantë: ndërthurja e qasjes teorike, me një mori shembujsh të jetuar e të qëmtuar nga përvoja e një protagonisteje që ka pasur avantazhin të shohë e njohë nga brenda dinamikën, mënyrën e funksionimit të jetës politike, partiake, vendimmarrëse qeverisëse përgjatë disa dekadash të rëndësishme të historisë sonë më të re, gjatë së cilave Valentina Leskaj mbajti poste me rëndësi.

Mendoj se një ndër vlerat e mëdha të këtij libri është se, veç kërshërisë së natyrshme që sjell gjithnjë mundësia që të jep një vepër që të lejon të shohësh sado pak atë që ndodh pas kuintave, është kontributi që libri “Politika si ide” sjell për të nxitur një debat mjaft të dobishëm për shumë prej atyre çështjeve që ai trajton.

Po në çdo rast, do të ishte krejt e gabuar ta shihnim librin “Politika si ide” thjesht si një libër kujtimesh, ndonëse në të gjen padyshim jo pak nga përvoja personale e autores, dhe elementi autobiografik shihet qartë, po asnjëherë si qëllim në vetvete, gjithnjë për të ilustruar e shtjelluar përsiatjet e autores lidhur me problemet që ajo shtjellon, e më në përgjithësi, përvojën komplekse të tranzicionit shqiptar.

Ky libër është para së gjithash një analizë e thelluar e mjaft prej problemeve e sfidave me të cilat u përball dhe vazhdon të përballet shoqëria dhe politika shqiptare gjatë dekadave që pasuan rënien e regjimit komunist. Po njëkohësisht, në këtë libër shtjellohen mjeshtërisht një sërë temash të tjera me shumë interes: kështu, ndër kapitujt që unë do të rekomandoja në mënyrë të veçantë, janë për shembull, kapitulli kushtuar gjuhës së urrejtjes, aq aktual gjithnjë në hapësirën shqiptare; kapitulli kushtuar çështjeve demografike, aq aktual për ne, por dhe më gjerë në mbarë botën e sotme; dhe padyshim, pjesa e librit që trajton çështjen e gruas,

ku Valentina Leskaj falë dhe përvojës së saj të gjatë si një aktiviste e shquar në lëvizjen e gruas, ka sjellë një kontribut vërtet të shquar.

Duke qenë një ndër njohëset e studiueset më të mira të historikut të lëvizjes feministe në Shqipëri, me vëmendje të veçantë te kontributi i grave në fushën e publicistikës, Valentina Leskaj në këtë libër (po jo vetëm) ka dhënë një kontribut me të vërtetë të vyer për të nxjerrë nga harresa një sërë figura mjaft interesante grash të cilat fatkeqësisht kishin mbetur deri më tani më së shumti të harruara.

Dhe së fundi, s'mund të rri pa venë në dukje një element që, për mendimin tim, ia shton po ashtu dukshëm vlerat këtij libri. "Politika si ide" mbulon një gamë aq të gjerë problemesh të rëndësishme, me një qasje të lakmueshme teorike dhe intelektuale, po ajo që e bën atë të veçantë është përpjekja për ta parë a analizuar çdo problem gjithnjë në një rrafsh krahasues, duke i parë problemet sfidat, politikat, e para së gjithash zgjedhjet e bëra brenda një konteksti global, në raport me përvojën e vendeve të tjera që janë përballur po ashtu me probleme e sfida të ngjashme.

Në mbyllje, u drejtohem lexuesve, me ftesën që ta merrni e ta lexoni librin "Politika si ide", duke iu siguruar se është një ndër librat më interesantë të botuar prej shumë vitesh në zhanrin e publicistikës.

Tiranë, 16 qershor 2021

DIANA ÇULI

Shkrimtare, përkthyes

**Gjuha e urrejtjes dhe barazia gjinore në librin
“Politika si ide”**

[...Të gjithë kapitujt mbi zhvillimet politike në Shqipëri, mbi problemet sociale, mbi gjuhën e urrejtjes janë një kontribut analitik për mëtejshmërinë e demokracisë sonë, për zgjerimin e pjesëmarrjes publike në zgjidhjen e problemeve në mënyrë sa më horizontale, për zhvillimin e një debati gjithnjë e më të qartë e të ndriçuar të aktualitetit, po dhe të ardhmërisë politike...]

Titulli i këtij libri, i përmbajtjes si rrallëherë, simbolizon vetë personalitetin e autores, e cila, nuk mund të kuptohet, për mua, por edhe për të gjithë ata që e njohin, pa përpunimin dhe analizën e paprerë të ideve, pa gjetjen e atyre të rejave. Ky libër është ndalesa e natyrshme e Valentina Leskajt për të hedhur në letër një pjesë të rëndësishme të analizave

të reflektimeve të saj rreth politikës shqiptare dhe të përvojës së saj të pasur dhe unike në këtë fushë gjatë këtyre tri dekadave të fundit. Është një reflektim dhe një analizë kryesisht mbi politikën e këtyre dekadave, mbi demokracinë, i sfidave që shoqëria shqiptare përballoi në këta 30 vjet, mbi dyshimet që na mundonin në vitet '90, kur togfjalëshat *demokraci përfaqësuese*, *demokraci pjesëmarrëse* dhe *demokraci funksionale* po dëgjoheshin për herë të parë në mjediset shqiptare.

Në këtë libër Valentina Leskaj nuk ka shkruar kujtime, ajo ka hedhur teza, ka trajtuar ide, ka debatuar mendime dhe opinione. Që janë e kundërta e diskurit bardh e zi *unë nuk të pranoj dhe ti më blasfemon*. Libri i Valentinës më ndërmend frazat e famshme të Norberto Bobbios: “Mësova të respektoj idetë e të tjerëve, të kuptoj përpara se të diskutoj dhe të diskutoj përpara se të dënoj”, se “detyra e intelektualëve është të mbjellin dyshime dhe jo të këmbëngulin për gjëra të sigurta”. Të gjithë kapitujt mbi zhvillimet politike në Shqipëri, mbi problemet sociale, mbi gjuhën e urrejtjes janë një kontribut analitik për mëtejshmërinë e demokracisë sonë, për zgjerimin e pjesëmarrjes publike në zgjidhjen e problemeve në mënyrë sa më horizontale, për zhvillimin e një debati gjithnjë e më të qartë e të ndriçuar të aktualitetit, po dhe të ardhmërisë politike.

Në libër, Leskaj ndjek, siç e ka ndjekur dhe në praktikë, gjatë shumë viteve, ecurinë e zhvillimit të mendimit politik shqiptar, ku qasjet e saj janë origjinale, negociuese, ofruese të zgjidhjeve dhe jo hapje llogoresh. E theksoj natyrën konfliktuale të politikës sonë, sepse ky rrugëtim politik, ekonomik dhe shoqëror ka qenë tepër i vështirë, me një *background* historik shekullor të bazuar mbi konfliktin dhe mbi kundërshtimin e *tjetrit*, që për shqiptarët, deri në vitin 1991 kryesisht kanë qenë pushtuesit dhe kundërshtarët politikë e ideologjikë.

Ajo vetë, që në vitet e para të pas '90-ës, kur ende nuk kishte hyrë në politikë, ka luftuar për negociatën dhe gjetjen e rrugëzgjidhjes, ka luftuar për krijimin e shoqërisë civile shqiptare - për herë të parë - në një Shqipëri ku kurrë nuk kishte pasur zë tjetër përveç atij të sundimtarëve e diktatorëve. Përveç rrjeteve e shoqatave shqiptare që Valentina që ngriti vetë e kontribuoi për të tjera të ngrihen, ajo është dhe një nga themelueset e Rrjetit Ballkanik të Grave dhe të Qendrës së UNESCO-s me bazë në Selanik, ku u zgjodh zv.presidente dhe me këtë rrjet udhëtoi nëpër qytetet e Ballkanit në flakë për të shpërndarë slogane për paqen. Dhe këtë synim të saj, këtë ide e vazhdoi edhe në angazhimin e gjatë në politikë, ku dha një kontribut tejet të vyer. Në këto periudha, kryesisht në atë të shoqërisë civile, unë kam qenë pranë saj, kam parë mënyrën si punonte, si nuk zmbropsej, si

këmbëngulte për të arritur synimin që kishim dhe mund të them sot, edhe pas disa dekadash, se ajo periudhë, por edhe më vonë ka qenë një shkollë më vete për mua, për ekuilibrin që ajo na mëson, përmbajtjen dhe zotërimin edhe të situatave më të vështira, maturisë, e mençurisë për të zgjidhur edhe konfliktet më të ndërlikuara,

Në sfidat që ka përballuar shoqëria shqiptare dhe politika e saj në këta 30 vjet, padyshim që dy prej tyre kanë qenë nga më të vështirat: së pari *gjuha e urrejtjes* dhe, së dyti, rënia drastike e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, në politikë dhe në administratë. Për këtë arsye dhe unë mendova të ndalem në dy kapitujt e librit që merren me këto çështje, pavarësisht se dhe gjithë kapitujt e tjerë kanë rëndësinë e tyre të veçantë.

Në analizën e saj rreth gjuhës së urrejtjes në politikë, në kapitullin me këtë titull, autorja ndjek gjithnjë bindjen e saj të palëkundur se kjo lloj gjuhe, në politikë, përbën një nga kërcënimet më të rrezikshme ndaj dialogut demokratik, për më tepër në një shoqëri me demokraci të brishtë si kjo jona, e cila në këta 33 vite me përpjekje tepër të mëdha po eksperimenton konsolidimin e saj. Valentina Leskaj depërton në motivet dhe arsyet që i shtyjnë politikanët të përdorin fjalor rëndë, fyes, apo edhe nxitës ndaj grupeve të caktuara, veçanërisht ndaj njeri tjetrit dhe në pasojat e këtij fjalori e kësaj gjuhe, që shkaktojnë

mosbesim te politika, polarizim në shoqëri dhe klimë frike e pasigurie. Përveç përçarjeve të thella, që është dhe një nga sfidat, mendon Leskaj, për t'i shmangur sa më tepër.

Rreziku që sheh Leskaj te përdorimi i gjuhës së urrejtjes është se shoqëria fillon të mësohet me demonizimin e kundërshtarit politik, të cilin e sheh si armik dhe jo si kundërshtar, ul cilësinë e debatit publik dhe mësohet me këtë sjellje si me një normë të pranueshme politike. *“Kur njerëzit në pushtet përpiqen të përçajnë për të fituar fuqi, kur ata nxisin urrejtjen ndaj atyre që janë ndryshe - kjo nuk është udhëheqje. Ky është frikësim”*, shprehet Barack Obama, ish-president i SHBA-ve. Pikërisht këtu, mendon Leskaj, qëndron edhe një nga sfidat tona, përmes një ligjërimi politik me etikë, respekt e argumentim racional, për ta penguar gjendjen e frikës që shkakton gjuha e urrejtjes, duke vonuar e ngadalësuar kështu demokracinë. Për të penguar cenimin e reputacionit të politikanëve kundërshtarë dhe shkeljen e dinjitetit të tyre, për të ndaluar krijimin e imagjinatave kolektive të mbushura me stereotipa të rrezikshëm dhe që vendosin kufij në mendjet e njerëzve. Dhe, më e rënda, thekson kjo analizë e Leskajt, është se gjuha e urrejtjes legjitimohet nga ata, që të parët duhet të jepnin shembullin e kundërt.

Krijohet nganjëherë përshtypja, te shumë shkrime në gazeta ose dhe në debate mediatike, se gjuha

e urrejtjes e përdorur nga politikanë të ndryshëm, por edhe nga përdorimi në përgjithësi një gjuhë me natyrë përçmuese, me gjoja terma neutralë, që janë fyes nga vetë mënyra si përdoren, janë diçka normale. Ndërkohë, fyerjet, që janë të zakonshme në sallën e parlamentit tonë, për fat të keq, nuk cenojnë vetëm persona të veçantë, por krijojnë situata negative në përgjithësi, duke shmangur vëmendjen nga problematikat e vërteta, duke kaluar te urrejtja, pra te emocione agresive në përgjithësi dhe jo në çështjet e rëndësishme e të vërteta të shoqërisë sonë.

Edhe për këtë dukuri ky kapitull mbi gjuhën e urrejtjes më duket me rëndësi të veçantë, edhe sepse, prej tri dekadash e më shumë politikanët shqiptarë, pavarësisht mjaft ndryshimeve e përmirësimeve, nuk heqin dorë prej saj, duke u bazuar në mendësinë primitive se kështu, duke u zgjuar zgjedhësve ndjenja agresive, i shtojnë të votojnë për ta. Për më tepër, në këtë botën tonë të sotme globale, sepse nuk mund të konceptojmë më politikën, përparimin shoqëror, ekonomik e kulturor pa këtë përkatësi, çështja e gjuhës së urrejtjes është rikthyer dhe po shihet me vëmendje, sepse ajo po ringjall përsëri jo vetëm diskriminim, por edhe përçarje të reja shoqërore. Madje, nga shumë studiues të të Drejtave të Njeriut, gjuhën e urrejtjes e shohin edhe si çështje juridike, sepse ajo mund të shndërrohet shumë shpejt në instrument shtypjeje. Për këtë arsye dhe

shumë të tjera, që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e një politike sa më frytdhënëse për zhvillimin e forcimin e demokracisë në Shqipëri, analizat dhe reflektimet e Valentina Leskaj mbi këtë temë janë të një rëndësie të madhe e të veçantë, pa harruar dhe faktin se rrallëherë - e asnjëherë në mënyrë kaq të thelluar - nuk i kemi vërejtur në diskutime, punime a analiza të autorëve të tjerë që shkruajnë mbi qasjet e politikës shqiptare.

Duke kaluar te tema e barazisë gjinore, do të ndalesha te kapitujt mbi valët e feminizmit e të politikave të barazisë gjinore në botë dhe në Shqipëri. Valentina Leskaj ka luftuar gjithë jetën e saj për këtë barazi dhe për barazinë e mundësive. *“Demokracia është barazia e të drejtave, por Republika është barazia e mundësive”* shkruante Kamýja dhe këtë frazë e të tjera të tij i gjejmë të varura në korniza në muret e zyrave të BE-së në Bruksel.

Protagoniste e suksesshme e jetës politike e jetës shoqërore, Valentina Leskaj është një shembull spikatës se si mund të konkurrohet në shoqëri jo si grua, por si qenie njerëzore. Ajo ka qenë gjithnjë e vetëdijshme se nuk mund të priste privilegje, siç thoshte shkrimtarja dhe aktivistja amerikane Betti Friedman për gratë që i hynin politikës, por as t’i nënshtrohej paragjykimëve dhe stereotipave.

Valentina Leskaj është një shembull i gjallë se si ndryshoi gjatë viteve niveli i fuqizimi i grave në

politikë, fuqizim që mban shenjën dhe kontributin e saj në pothuajse të gjithë ecurinë, sepse është një nga promotoret kryesore të ligjit të të Drejtave të Riprodhimit, të përfshirjes së Kuotës Gjinore në politikë dhe të shumë ligjeve të tjera. Duke rikujtuar vitet e para '90, kur Leskaj, në krye të shoqatës së saj u angazhua me të gjitha forcat për miratimin e ligjit të të Drejtave të Riprodhimit, për koalicionin e shoqatave që krijoi për këtë qëllim, për bashkëpunimin me deputetë e ligjvënës, shqiptarë e ndërkombëtarë, dëshiroj të theksoj se ajo ishte një ndërmarrje që shumëkush e shihte si të pamundur. Ishte Shqipëria e viteve të para '90, kur, me gjithë aspiratat për ndërtimin e një shoqërie demokratike, kultura dhe mentalitetet e vjetra, të trashëguara nga regjimi dhe nga shumë tipare konservatore e patriarkale të shoqërisë sonë ende ishin të gjalla e të forta. Por, vizioni i Leskajt për të garantuar shëndetin, autonominë dhe të drejtat e grave në fushën e riprodhimit ishte i palëkundur e shumë i qartë. Demokracia nuk ishte një koncept virtual, perëndimor, pas të cilit duhet të nxitonim pa u menduar, “se këtë punë e dinin perëndimorët”, si po perceptohej jo rrallëherë në masë, por edhe një proces shumë i ndërlikuar, që kërkonte një ndryshim të madh kulturor. Për këtë arsye, edhe kërkimi i miratimit të këtij ligji, që lidhej me pavarësinë e vetëvendosjen e grave për jetën e tyre, me shëndetin publik e uljen

e vdekshmërisë së grave, me barazinë shoqërore dhe zvogëlimin e pabarazive, me lirinë e zgjedhjes dhe të të drejtave të njeriut, nuk ishte i thjeshtë. E përmend këtë ligj dhe periudhën e vështirë kur u miratua, me nismën edhe këmbënguljen e Valentina Leskajt, edhe si një udhërrëfyes për angazhimin e saj të gjatë në fushën e barazisë gjinore, sepse, siç e përmenda dhe më sipër, ajo nuk tregon për betejat e saj, por flet për rëndësinë e ideve - në këtë rast të barazive - duke theksuar atë gjinore.

Të njëjtin vullnet dhe qëndrim ajo e shfaqti edhe në kohën e miratimit të ligjit të kuotës gjinore, ndërkohë që ishte dhe vetë në pozita drejtuese në parlament dhe, si përherë e nisur nga parimi dhe koncepti i të drejtave dhe të barazive dhe kontribut të veçantë edhe për këtë ligj, i cili synon të garantojë një përfaqësim më të ekuilibruar të burrave dhe grave në organet vendimmarrëse, veçanërisht në sektorët ku gratë janë tradicionalisht të nën-përfaqësuara. Dhe, nëse sot kemi një qeveri ku pothuajse gjysma janë gra, një administratë ku diskriminimi numerik pothuajse nuk ekziston, një sistem drejtësie, ku nuk vihet më re pabarazia në drejtim apo në përfshirje, do të shtoja se kjo situatë është dhe një nga kontributet e saj të drejtpërdrejta. Dhe vetë roli i saj si kryetare e grupit parlamentar, si ministre e punës dhe çështjeve sociale, si nënkryetare e parlamentit e shumë detyra të tjera politike në zonat ku ka kandiduar,

si Elbasan e Vlorë, ka vërtetuar tezën e barazisë gjinore se gratë dhe burrat duhet të jenë të barabartë në mundësitë për drejtim, por, duke qenë dhe të ndryshëm në zgjidhjet dhe propozimet që japin, ata e pasurojnë jetën politike së bashku. Zgjidhjet dhe propozimet e Valentinës, ashtu si ajo lufton kundër gjuhës së urrejtjes, kanë qenë gjithnjë zgjidhje *pro* dhe jo *kundra*, bashkëpunim dhe jo ndarje, vazhdim i punës për të mirën e shoqërisë dhe jo bllokim i saj. Ky është një mësim demokracie, që unë dhe shumë të tjera e kemi parë në praktikë dhe e kemi mësuar prej saj.

Duke iu rikthyer librit, do të shtoja se edhe betejat gjinore Valentina Leskaj nuk i ka pasqyruar si vetjake, madje pothuajse nuk ka shembuj nga puna e saj, por ka reflektimin mbi to, ka thellim, diskutim dhe propozime, gjykime. Historiku mbi valët e feminizmit në botë, për shembull, nuk është thjesht një pasqyrim i zhvillimit të kësaj lëvizjeje që ndryshoi situatën e gruas në shumicën e vendeve të botës, brenda pak a shumë njëqind viteve, si nuk kishte ndodhur në dy mijë vitet e fundit, por një analizë e vëmendshme dhe sintetike, të cilën kushdo që ka ide të përgjithshme e klishe mbi feminizmin e barazinë gjinore, merr një konceptim të ri e të ndryshëm. Për shkak të propagandës së regjimit të kaluar, që pretendonte se emancipimi i gruas, sipas kodeve të atij regjimi, ishte e vetmja rrugë emancipuese dhe

barazitare, duke kritikuar rëndë dhe në mënyrë të pabazë feminizmin botëror, ende në Shqipëri ka paragjykiye dhe skepticizëm, ose thjesht mosnjohje në këtë drejtim.

Libri i Leskajt shërben edhe në këtë rast, përveç thellësisë së mendimit dhe interpretimeve që ajo i bën kësaj lëvizjeje dhe zhvillimit të saj në botë e në Shqipëri. Veçanërisht, nga këta kapituj, çdo lexues e merr shumë qartë idenë e barazisë dhe jo njësimin, idenë se burrat dhe gratë janë të ndryshëm, por të barabartë para ligjit dhe mundësive, se feminizëm nuk do të thotë luftë kundër burrave, siç propagandonte regjimi apo paragjykiye të sotme të pathelluara, por bashkëpunim i barabartë me ta, se betejat për të drejtat e njeriut - jo vetëm nuk kanë mbaruar, se pabarazia mund të shfaqet papritmas, kudo, në shumë pamje të ndryshme, qofshin raciste, gjinore, orientim seksual, etnike, pjesëmarrje politike e të tjera.

Në këtë përsiatje më vjen ndër mend një thënie e Simone Veilit - presidente e Parlamentit Europian, ministre, por dhe aktiviste e palodhur, që thoshte se *“unë kërkoj që diferenca ime si grua të merret parasysh, por nuk kam aspak frikë të punoj njësoj si burrat”*. E kam menduar gjithnjë këtë shprehje, sa herë kam ndjekur Valentinën në punën dhe në idetë e saj. Libri *“Politika si ide”* i Valentina Leskajt është një kontribut i vyer mbi mjaft çështje, që sot

kërkojmë të kuptojmë, të përmirësojmë, të zgjidhim.

Mendoj dhe shpresoj, se ky libër do të pasohet nga të tjerë të shkruar prej Valentina Leskajt, për t'u dhënë në dorë lexueseve në përgjithësi, politikanëve më të rinj, grave dhe vajzave që dëshirojnë të jenë të suksesshme e të padiskriminuara në jetë, ide të frytshme, frymëzuese, konkrete, por edhe reflektuese, mbi të gjitha këto çështje që janë kaq jetike për shoqërinë shqiptare dhe për politikën e saj.

***Fjala e mbajtur në promovimin e librit
“Politika si ide”, në Tiranë, 10 tetor 2022***

PROF. DR. ENVER HOXHAI

Politika si Ide, përtej një historie personale!

[...Duke vepruar në një periudhë të tranzicionit drejt pluralizmit politik dhe demokracisë, tregut të lirë, një ekonomie të qëndrueshme dhe mundësive të barabarta, barazisë gjinore dhe mediave të lira, Valentina Leskaj dallohet në zhurmën e madhe të politikës shqiptare si politikane që ndoqi çdo rrugë të arsyes, duke mbetur zëri i arsyes. Për të, politika ka vetëm një drejtim: progresin. Politika ka të bëjë mbi të gjitha me të ardhmen. Në këtë libër shihet se ky është misioni i saj...]

Në kohën kur Shqipëria po shkëputet gradualisht nga Ballkani, duke iu bashkuar BE-së, ndoshta rreth vitit 2030, por kur vetë Perëndimi, si koncept e kulturë, po ballkanizohet, libri i Valentina Leskajt është një ftesë origjinale mbi tranzicionin shqiptar. Gjithashtu, ai është ftesë për të menduar të ardhmen

tonë në një botë shumë të pasigurt, të fragmentuar, me kriza, konflikte dhe luftëra të papërfunduara. Idetë dhe institucionet, për të cilat u angazhua Valentina Leskaj, janë më të rrënjosura e më të konsoliduara se kurrë në Shqipëri. Mirëpo, këto koncepte, brenda vetë shteteve liberale perëndimore, në Evropë dhe jashtë saj, janë të kërcënuara si asnjëherë më parë.

Sot duket bota, kur lexojmë mediat ndërkombëtare, si një humnerë në pafundësinë galaktike, ku janë groposur kauzat e mëdha, duke bërë që shumëkush të humbasë shpresën se gjërat do të kthehen ndonjëherë në binarë. Kur përmbyll leximin e librit, brezi ynë i politikës në Tiranë e Prishtinë duhet të bindet se nuk duhet ta humbasë assesin as shpresën dhe as besimin. Fati ynë duket se është i paracaktuar më shumë se kurrë për t'u bërë pjesë e BE-së, por BE-ja s'do të mbetet çfarë është sot, kur një ditë do të arrijmë të përmbushim këtë mision historik: të rikthimit tonë në Evropë.

Libri i Valentina Leskajt flet për personalitetin politik e intelektual, përvojën personale e publike të saj. Është një histori personale e Shqipërisë, jo një autobiografi. Është një analizë e mirëfilltë mbi “rrugën brenda meje”, siç e definon ajo: si intelektuale me një zë të veçantë; si pedagoge në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës; si aktiviste e shoqërisë civile duke u bërë një figurë emblematike e saj; deri te angazhimi i saj në politikë,

duke u bërë personalitet udhëheqës i saj. Por ka edhe një rrugë të jashtme të saj, që është rruga e Shqipërisë në kohë dramatike, të tranzicionit nga regjimi i egër komunist drejt një shoqërie demokratike. Duke vepruar në një periudhë të tranzicionit drejt pluralizmit politik dhe demokracisë, tregut të lirë, një ekonomie të qëndrueshme dhe mundësive të barabarta, barazisë gjinore dhe mediave të lira, Valentina Leskaj dallohet në zhurmën e madhe të politikës shqiptare si politikane që ndoqi çdo rrugë të arsyës, duke mbetur zëri i arsyës. Për të, politika ka vetëm një drejtim: progresin. Politika ka të bëjë mbi të gjitha me të ardhmen. Në këtë libër shihet se ky është misioni i saj. Kështu ishte edhe në karrierën politike të Valentina Leskajt.

Ky libër është shkruar pas largimit të saj nga politika, si lamtumirë e politikës. Sa ishte në politikë, Valentina Leskaj u angazhua në politikë sepse ajo ishte pasioni i saj. Kjo *“ishte kohë pasionesh”*, thotë ajo vetë (f.88). Kjo është edhe një arsye e mirëfilltë pse duhet të lexohet ky libër sot në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup. Kjo sepse jo vetëm tek ne shqiptarët, por edhe në Uashington, Londër, Berlin dhe Paris po flitet gjithnjë e më shumë mbi *“fundin e pasionit politik”*. Valentina Leskaj ende sot, aktivisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, merret me tema politike shqiptare dhe botërore. Ajo është e angazhuar me pasionin e njëjtë për idetë për të cilat qëndroi në

politikë për tri dekada dhe të cilat i mbështet edhe sot.

Fuqishëm e mbështeti Kosovën në rrugën e saj të lirisë dhe të pavarësisë. Kudo që unë kam udhëtuar në vende të ndryshme të botës si Ministër i Jashtëm, do ta përmendnin të tjerët ndikimin e saj në mbështetje të Kosovës. Ende sot, Valentina dhe unë bisedojmë për tema të shqiptarëve, por edhe globale. Rezolutat e miratuara në Kuvendin e Kosovës u frymëzuan dhe sugjeruan nga ajo. Disa qëndrimet tona politike për tema ndërkombëtare e kishin pikënisje vetë Valentinën Leskaj.

Duke e përkufizuar shkurt këtë libër, mund të them me bindje të plotë se ai është testamenti i një kohe kur politika u përjetua si pasion që lidhet me përmbushjen e fatit racional të Shqipërisë. Ajo i shërbeu këtij fati politik si politikane me ide të qarta, intuitë të veçantë politike dhe e ekuilibruar në gjykimin politik. Meqë kam jetuar për shumë vite në Vjenë, ma kujton shumë ekuilibrin habsburg në sjellje dhe gjykim. Meqë për më shumë se tri dekada jam i lidhur shumë me Berlinin, kur bisedoj me të, ajo më ngjan me ato zonjat prusiane të politikës gjermane, si mendje politike me nuhatje të veçantë.

Sa ishte në politikë dhe gjithashtu në shkrimin e librit, ajo tregon sesi njeriu ka nevojë për *“distancë të shëndetshme”* dhe *“për t’i parë gjërat më ftohtë”* (f. 163). Ka qenë fati i saj racional për të kontribuar

në një Shqipëri demokratike, të anëtarësuar në NATO, ku vetë ajo kishte ndikim dhe kontribut. Kur sot Shqipëria gradualisht po i lëviz BE-së dhe Valentina Leskaj u angazhua shumë për të ndërtuar një Shqipëri evropiane, duke është përmbushur një qëllim madhor politik.

Pse ky libër sot, më 2025, është ende me peshë për debatin politik? Sepse është një thirrje për aktivizëm, por edhe për t'u bërë pjesë e politikës: e politikës si profesion. Valentina Leskaj beson “fort se çdo njeri i angazhuar bën politikë”, sepse ai ngrit zërin për çështje të interesit të përgjithshëm. Veçanërisht ata që janë aktivë në media, në shoqëri civile e advokojnë çështje e tema të ndryshme. Ata që janë ende jashtë politikës është me rëndësi të angazhohen politikisht. Ndoshta, edhe nuk ka profesion më interesant.

Politika në Shqipëri ka përfituar nga Valentina Leskaj në disa mënyra të angazhimit të saj qytetar: duke nxitur qytetarët të marrin pjesë në politikë; duke përfaqësuar interesa për grupe të ndryshme shoqërore; duke siguruar që politikatat të pasqyrojnë nevojat dhe aspiratat e ndryshme; duke ofruar zgjidhje inovative për probleme të vështira ku shërbimet qeveritare nuk janë aty; duke e mbajtur qeverinë përgjegjëse për veprimet e saj; duke kërkuar llogaridhënie dhe transparencë; duke nxitur bashkëpunimin mes qeverisë dhe organizatave

ndërkombëtare; duke përmirësuar legjislacionin. Këto çështje i përfaqësoi ajo në shoqërinë civile. Këto çështje dhe tema ajo i përfaqësoi si Ministre dhe Deputete në Kuvend dhe në Qeveri. Të gjitha këto ende i përfaqësojnë shoqëria civile, akademikët, opinionbërësit dhe aktivistë të ndryshëm në Shqipëri. Përvoja e saj në shoqëri civile dhe vetë libri janë ftesë për angazhim politik.

Nëse dikush ka ende dilema, ajo tregon sa është një vendim i vështirë, duke filluar nga vetvetja; se çfarë mendon familja; por për shkak të mjegullës së paqartësisë që shtrihet përpara në horizont. Vendimarrja për të hyrë në politikë është shumë e vështirë, përbën një dilemë të veçantë, sepse *“politika është vendi ku njeriu mund të humbasë një pjesë të vetes, ndoshta edhe atë pjesë që e quan më të çmuar”* (f.140). Por njerëzit hyjnë në politikë sepse e ndjejnë një thirrje të brendshme. Por është edhe një thirrje e shoqërisë, sikurse e kishte shoqëria shqiptare një pritje për Valentinën Leskaj. Prandaj, për atë, politika nuk është thjesht profesion, por është mbi të gjitha thirrje.

Në librin e saj e hasim shpesh si referencë klasike të mendimit dhe ideve politike edhe esenë më interesante të shkruar ndonjëherë për politikën, esenë e Max Weber. Gjithmonë kisha në tavolinën time tre autorë të mëdhenj, që në fakt ishin si vëllime të librave të vegjël, në botime të bukura e gjuhë të

ndryshme: Mark Aurelin, Niccolò Makiavellin dhe Max Weber. Të fundit e kam lexuar dhe rilexuar dhjetëra herë. Kur e lexova librin e Valentina Leskaj mbeta i habitur sesa ajo i ka mishëruar në angazhimin e saj disa nga idetë themelore të tij. Libri i saj është në kërkim të natyrës së politikës, cilësive që duhet të kenë politikanët; flet për ndjenjën e përgjegjësisë dhe etikën në politikë; për idealin politik dhe realitetin; për partitë, zgjedhjet dhe legjitimitetin politik; gjithashtu trajton tërthorazi temën e pushtetit, autoritetit e lidershipit. Të gjitha në shembullin e Shqipërisë, si përvojë personale.

Ajo përmend edhe intelektualë të tjerë me ndikim, duke qenë në kërkim të kuptimit të ideve politike, politikës moderne, lidershipit dhe qeverisjes. Karl Popper, Václav Havel, Anthony Giddens, Fareed Zakaria dhe idetë, pikëpamjet dhe shkollat e mendimit janë pjesë e librit. Por edhe personalitete të tjera botërore si Bill Clinton, Madeleine Albright në SHBA, shumë të tjerë në Evropë, Afrikë dhe në gjeografinë globale që i takoi dhe me të cilët bashkëpunoi. Ajo është në kërkim të kuptimit dhe të natyrës së politikës, jo vetëm mbi bazë të tyre, por për shkak të udhëtimeve të shumta në vende të ndryshme të botës, duke pasqyruar përvojat e saj dhe treguar mbi karakterin e njerëzve, botëkuptimet e tyre dhe kauzat politike për të cilat qëndronin ata. Në politikë të duhet një botëkuptim filozofik, por

edhe një imagjinatë praktike. Kur takon politikanë të rangut botëror dhe bashkëbisedon me ta, imagjinata praktike merr formën më të mirë.

Libri i saj është titulluar “Politika si ide”. Duke mos qenë një libër kujtimesh, memoare politikanësh, është më shumë përvoja e saj personale në politikë, e një gruaje të fortë që jetoi për politikën, në shërbim të Shqipërisë e shqiptarëve. Cilat ide e kauza e motivonin atë në politikë dhe për çfarë qëndroi Valentina Leskaj në udhëtimin e saj politik për tri dekada? Në këtë libër voluminoz ajo trajton tema të shumta: të kulturës politike në Shqipëri, pjekurisë demokratike, ndarjeve ideologjike në të majtë dhe të djathtë, të zhvillimeve sociale e demografike, të plakjes së popullsisë dhe rënies së lindshmërisë, të diskursit publik dhe gjuhës politike. Unë do të fokusohem në tri tema bosht të librit.

Ndër temat e para është pozita, roli dhe të drejtat e gruas në shoqëri, duke e trajtuar atë nga perspektiva shqiptare dhe globale, të lëvizjeve feministe dhe pikëpamjeve intelektuale feministe. Premisa kryesore është që shoqëritë ku gratë marrin pjesë dhe udhëheqin në tema të politikës, ekonomisë, arsimit dhe kulturës, kanë ndërtuar familje dhe shtete të shëndosha. Ajo mbetet kritike ende për avancimin e pozitës së gruas në Shqipëri; barazia gjinore është avancuar, kur shohim se të drejtat e grave në këto tri dekada kanë pësuar transformim të

madh: rritja e përfaqësimit politik, pjesëmarrjes në ekonomi dhe rritja e nivelit të arsimit të tyre. Ndërsa dhuna gjinore, pagat më të ulëta dhe probleme të tjera strukturore flasin për sfida serioze që mbestin.

Një temë tjetër bosht që e përshkruan librin nga fillimi deri në fund, është çështja nëse ka arritur Shqipëria të ndërtojë një demokraci funksionale. Demokracia ka qenë në Shqipëri gjithçka në këtë periudhë të tranzicionit. Ajo ishte si ideal politik e shoqëror, sistem politik e formë qeverisjeje, por ende ballafaqohet me sfida serioze: *“Jemi një vend ku ende diskursi politik vërtitet rreth demokracisë minimale, siç e quan atë Karl Popper, ende pas gati 30 vitesh kemi mbetur te debati për mungesën e dialogut politik apo ai për zgjedhje të lira e të ndershme...”* (f.148). Natyrisht, këtu përmendet një listë e gjatë e temave të deficitit demokratik ende në Shqipëri. Si një demokraci parlamentare e konsoliduar, Shqipëria, për t’u bërë anëtare e BE-së, ka nevojë të bëjë reforma të mëtejshme në fuqizimin e demokracisë, ekonomisë, qeverisjes, sundimit të ligjit, pavarësisë së gjyqësorit dhe luftës kundër korrupsionit.

Kjo pjesë e librit është kontribut jo vetëm për t’i kuptuar sfidat e demokracisë shqiptare, por edhe sfidat e demokracive liberale perëndimore. Meqë në këto vende demokracia është nën kërcënim serioz nga rritja e populizmit; shqetësimet për sovranitetin

kombëtar; zhvendosjet ekonomike; polarizimin, fragmentimin dhe përçarjen e shoqërive; minimin e normave dhe të institucioneve demokratike; erizionin e institucioneve; kërcënimet ndaj gjyqësorit të pavarur, ndaj mediave të pavarura e lirisë së fjalës. Një spektakël të tillë tërheqës, për të përmbushur gjoja kërkesat e shoqërisë, po ofron një pjesë e politikanëve në Kosovë dhe Shqipëri. Në thelb, është një mjerim politik, në mungesë të ideve konkrete për të ofruar zgjidhje politike për probleme reale në shoqëri. Politika e atyre që promovojnë një diskurs të tillë ka hyrë moti në një rrugë të diskreditimit.

Politika është lufta për ta fituar dhe mbajtur pushtetin. Valentina Leskaj, duke e njohur mirë premisën teorike dhe duke qenë gjatë në politikë, e kuptoi që herët se të gjitha i shërbejnë këtij objektiv. Në libër, ajo tregon sesi lufta për pushtet bën që raportet mes partive rivale të funksionojnë në një raport të mikut dhe të armikut, siç i ka përshkruar në mënyrë të shkëlqyeshme vetë Carl Schmitt. Por ajo i kushton një vëmendje të veçantë konfliktit politik në Shqipëri, mjerisht si pjesë e jetës së përditshme të politikës dhe institucioneve. Edhe vetë teoricienët më të mëdhenj do të ishin të varfër në imagjinatën e tyre për të kuptuar përmasën e konfliktit politik në Shqipëri.

Kur mungojnë idetë konkrete politike, kur ndodhin dështimet zgjedhore ose edhe kur mungojnë

argumentet politike në debatet në Kuvendin e Shqipërisë, gjuha e urrejtjes, dhuna verbale dhe tensioni i përleshjeve fizike përdoren për të treguar se gjoja një dramë e madhe është në lojë. Një gjë e madhe që është, duke dëmtuar gjoja interesat e qytetarëve dhe interesin kombëtar. Çdo shoqëri ka nevojë për një konsensus, dhe Shqipëria, që duket se është në një fazë kritike të anëtarësimit evropian, herët a vonë do të ketë nevojë për një shkallë të caktuar të konsensusit. Ai mund të arrihet në mënyra të ndryshme, por konfliktualiteti i politikës në Shqipëri e bën sot diçka të paarritshme.

“Mendoj se një nga problemet e politikës në Shqipëri është se ajo është më shumë e dominuar nga e përditshmja, e cila përgjithësisht udhëheq drejt zgjedhjeve afatshkurtra, që lidhen me zgjedhjet e radhës, dhe më pak e orientuar nga qasja strategjike dhe zgjidhjet afatgjata” është ndër orientimet themelore të Valentina Leskaj në politikë dhe në librin e saj. Si u transformua Shqipëria në këto tri dekada të tranzicionit, mund të kuptohet më së miri nga libri i saj. Por ajo nuk e sheh këtë histori të sfidave dhe të suksesit të Shqipërisë prej vendit ku u gjend ajo vetë. Nga libri kupton se politika është hapësira më interesante ku njeriu si qytetar bëhet subjekt politik; bëhet aktor politik në shërbim të diçkaje më të madhe, të mbajtjes së një premtimi të madh të dhënë dhe të një zotimi që duke u zbatuar ndërton një realitet të ri.

Libri tregon për një përpjekje shembullore për ta menduar dhe praktikuar politikën ndryshe; përtej temave ditore të ballafaqimit politik në interesat afatgjata të shoqërisë. Libri tregon sesi një klasë politike në tranzicion i kishte hyrë punës për të ndërtuar një vend dhe shoqëri të re; sesi politikanët intelektualë u bënë një figurë emblematike që udhëhoqi me politikë të frymëzuar nga idetë, nga ndërgjegjja e pasioni politik. Valentina Leskaj kishte hyrë në jetën publike dhe më vonë në politikë në një moshë të re, si një grua ambicioze, një nënë dhe bashkëshorte e përkushtuar, në një kohë kur politika në demokracinë e re shqiptare kishte gjetur magjinë e saj. Dhe thesari i kësaj magjie të njohur si politikë është ndërtuar mbi disa shtylla kryesore: mendimi, dialogu, vendimmarrja dhe shkrimi.

ALFRED PEZA

Gazetar

“Politika si ide” e Valentina Leskajt

[...“Politika si ide” është libri, që shndërrohet sapo e përfundon, në një busull për këdo që është i interesuar për zhvillimet kyçe që kanë shënuar jetën shqiptare. E ke të lehtë ta gjesh rrugën për atje, kur bazohesh te përvojat personale të autores, harmonizuara me eksperiencat dhe ajkën e mendimit botëror...]

Kur në shkurt të 2016 Edi Rama tha “unë jam feminist se jam socialist, po duan s’duan jam edhe artist”, fjalja tingëlloi bukur duke bërë xhiron e mediave. Ishte takimi i madh i Forumit të Grave Socialiste dhe gjysma e parë e frazës së famshme që ishte artikuluar fillimisht nga ish Kryeministri spanjoll Jose Luis Zapatero, e ngriti entuziazmin në atë sallë të stërmbushur me gra e vajza. Ishin vitet që po ndryshonin njëherë e përgjithmonë, historinë

e vendit ballkanik, dominuar nga kultura maskiliste. Vetëm 5 vjet pas kësaj, Shqipëria do të futej në top 10 vendet e para të botës, që kanë më shumë gra në qeveri. Ndaj Valentina Leskaj nuk kishte si të mos ndihej krenare, ndërsa shihte të realizohej para syve të saj, njëra prej kauzave që i kishte kushtuar jetën. E kishte nisur angazhimin e saj disa dekada më parë si gazetare, për ta vijuar si aktiviste e të drejtave të njeriut, e drejtuese e shoqërisë civile. Anëtare qeverie e deputete. Kryetare e Grupit Parlamentar të PS dhe nën Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë.

Një grua e angazhuar në rreshtin e parë të përpjekjeve për emancipim shoqëror, nuk mund të ndihej plotësisht e realizuar, nëse nuk do ta linte të shkruar “testamentin” e saj. “Politika si ide” është libri prej 400 faqesh, që shndërrohet sapo e përfundon, në një busull për këdo që është i interesuar për zhvillimet kyçe që kanë shënjuar jetën shqiptare. E ke të lehtë ta gjesh rrugën për atje, kur bazohesh tek përvojat personale të autores, harmonizuara me eksperiencat dhe ajkën e mendimit botëror.

Bashkëbisedimi i Valentina Leskajt me Alda Bardhylin, na ndihmon që të kemi një vështrim 360 gradësh, për ngjarjet dhe fenomenet që kanë shënjuar identitetin e ri shqiptar. Fati e ka dashur që të udhëtojë herët dhe përgjatë gjithë jetës. Ajo ka shkuar nga jugu në veri të vendit, nga poli i veriut e deri në skajin më të largët të Afrikës së Jugut, nga lindja në perëndim të Shqipërisë, nga Japonia

në SHBA rreth e rrotull globit - duke u shndërruar në një eksploratore të së ardhmes, që ka shqisën e veçantë për të nxjerrje kudo mësim nga e shkuara.

Edhe kur është ndalur në rrugë për të folur me nënën e varfër të 10 fëmijëve që punonte tokën, edhe kur është takuar me më të fuqishmit e këtij planeti, edhe kur ka medituuar në qelinë ku kaloi 27 vitet e jetës së tij unikale Nelson Mandela, Valentina Leskaj duket sikur ka pasur të njëjtin preokupim. Të njëjtin shqetësim. Të njëjtën shtysë. Të njëjtën ndjesi. Të njëjtën përgjegjësi: Si mund ta shndërrojmë çdo sfidë, në një mundësi të re, për të ardhmen e përbashkët të gjithkujt.

Edhe kur flet për historikun e feminizmit, edhe kur përshkruan rrugën brenda vetes, edhe kur analizon të majtën e të djathtën, teknologjinë e demokracisë dhe kulturën e saj, reformat e strukturën e qeverisë, ministrinë e Punës e të Çështjeve Sociale që ka drejtuar, sistemin politik, luftën e brezave dhe sfidat e gruas në politikë, Valentina Leskaj nuk e konsideron lexuesin nxënës por bashkudhëtar të denjë. Në këtë libër me qasje gati-gati Presidenciale, ju mund të kuptoni fare qartë sesi idetë e saj të majta, nuk interferojnë për ta eklipsuar në mënyrë partizane optikën gjithëpërfshirëse. Rrallëkush nga njerëzit e angazhuar në një kahje politike në Shqipëri, ia del ta ruajë ekodistancën edhe me kundërshtarët më të egër, përmes një qasje përbashkuese në interes të publikes.

Edhe pasi ka takuar Sekretarin e Përgjithshëm të OKB dhe Presidentët e SHBA, edhe pasi shtrëngon duart me Hillari Klinton, Madeleine Albright dhe fitueset e çmimit “Nobel”, Kryeministra, Princër - Valentina Leskaj është e njëjta. Është po ajo kolegia që kam pasur fatin të jem në të njëjtin grup parlamentar, të fton natyrshëm të jesh pjesë e takimeve të rëndësishme politike, apo fqinja e derës ngjitur pranë zyrës së një media online, ku banon në një pallat modest në Tiranë. Edhe kur shkruan për pushtetin e fjalës, apo gjuhën e urrejtjes, tolerancën fetare e politike, zhvillimet demografike, varfërinë, punësimin dhe zhvillimin social, - ajo imponohet përmes ideve, argumenteve shteruese dhe një qasje ndryshe. Vali Leskaj nuk ka patur nevojë të ulërasë a të godasë ndokënd poshtë brezit, për tu bërë ajo që është. Sepse tek qytetaria dhe urtësia, fshihet sekreti i suksesit të saj, përmes një jete të jashtëzakonshme.

Kam qenë përballë saj kur iu drejtua Sali Berishës emrin e të cilit e ka evituar në tekst: “Harroje që mund të më ndryshosh standardin tim me gjuhën tënde, se nuk do ta ndryshoja kurrë, për asnjë arsye e nga asnjë presion”. Është një standard që e ka ruajtur dhe lartësuar si kurrë më parë, edhe në këtë libër, që do të jetë për një kohë të gjatë një tekst referimi që i kishte munguar bibliotekës sonë jo vetëm politike.

Gazetat, Panorama, Koha Jonë, Tirana News etj., 11 maj 2021

DR. IDA XOXA

Studiuese, përkthuese

Premtimi i demokracisë

[...Diskutimi mbi kapërcimin e supozuar të koncepteve të tilla, si e djathta dhe e majta, ka edhe një defekt të thellë: ai nënkupton një besim që, në botën e sotme, ka nevojë për më pak politikë nga sa nevojitet një herë e një kohë, ose më saktë, më pak ideologji, më pak parti, më pak qeveri, a thua se gjithçka varet nga të qenët të disponueshëm apo të padisponueshëm për ndryshimin intensiv, njësoj si progresi i përgjithshëm i njerëzimit...]

Kur në 1955 teoricienes Hannah Arendt iu propozua të shkruante një “Hyrje në politikë”, ishte pikësynim i sajë të mos shkruante një traktat me karakter akademik, por një diskutim mbi konceptet kyçe të shkencave politike e sociale që mund të qartësonin pyetjet kryesore lidhur me karakterin e vetë qenies

njerëzore po aq sa të politikës, të asaj çka është politike. Kësisoj Arendt, ndonëse “Hyrje në politikë” nuk e përfundoi dot në atë periudhë për shkak të ngjarjeve të viteve Pesëdhjetë dhe Gjashtëdhjetë, por sikurse do të dalë në pah në të gjitha veprat e saj të mëtijshme, ngulmonte në rëndësinë për të përcaktuar kuptimin e politikës, duke e njehsuar atë me idenë e pluralitetit - *pluralitas* - të qenësisë së shumëfishtë, të shumësisë. Një përcaktim i përfutur nga identifikimi i vetë qenies njerëzore me faktin e të qenit *pluralitât*. Më vonë, në pasthënien e përmbledhjes së disa shënimeve të Arendt nën titullin “*Was ist politik?*”¹, publikuar në 1993, adaptimi i së cilës në anglisht mban titullin “*The Promise of Politics*”² (2005), theksohet pikërisht ky parim, duke sjellë përsëri në pah dimensionin realist, po aq sa idealist të Arendt.

Ende mbetet aktual thellimi që Arendt i dedikonte kësaj çështje këtu e thujse shtatëdhjetë vjet më parë, duke konsideruar jetëgjatësinë e paragjyqimit që moderniteti ka ndërtuar kundrejt politikës dhe politikës. Ndaj Arendt vjen ende sot në ndihmë kur mendojmë për rreziqet që shfaqen nëse konsiderojmë

¹ Hannah Arendt, *Was Ist Politik?* Fragmente Aus Dem Nachlass, kuruar nga Ursula Ludz, Kurt Sontheimer. München, Piper, 1993.

² Premtimi i Politikës. Shiko Hannah Arendt, *The Promise of Politics*, parathënie nga Jerome Kohn. New York, Schocken Books, 2005.

politikën si mjet për të arritur një qëllim, qëllim që jo domosdoshmërisht gëzon legjitimitetin e justifikimit. Për një qëllim që qëndron jashtë kufijve të synimit parësor të politikës, që është liria, kujton Arendt, vetë parimet e politikës janë në rrezik. Mbi faktin e pluralitetit, i kuptuar edhe si larmi edhe si shumësi, Arendt vendos themelin e politikës. Pra, politika është pluralitet; nëse nuk është e tillë, politika nuk është, dhe pikërisht falë pluralitetit, liria politike dhe barazia mund të zhvillohen në një shoqëri.

Natyrshëm vijnë në mend këto fjalë gjatë leximit të librit të Valentina Leskaj, ku aq fort e drejtë përkrahet i njëjti parimi i gjerë i pluralitetit me të cilin Arendt përcaktonte politikën vetë. Në të njëjtën mënyrë, edhe “Politika si ide” nuk synon të jetë një krijesë teorike e formës së traktatit akademik, por një thellim mbi mënyrën se si duhet ta jetojmë si komunitet dhe si individë, politikën e menduar si hapësirë lirie.

Që në fillimet e saj, shfaqja moderne e politikës si hapësirë lirie dhe barazie, sikurse e mendojmë sot, mbetet në thelb një përpjekje për të siguruar pikërisht këtë hapësirë. Sikurse shkruante Asambleja kushtetuese franceze, në ditën e nxehtë të gushtit teksa ngjizej Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit në vitin 1789 - laborator studimi ende sot i pashtershëm - çdo njeri lind i lirë dhe i barabartë

në të drejta³. Askush, as vetë aktorët e ditëve të para të Revolucionit francez nuk mund të imagjinonin sa të fuqishme këto fjalë do të mbeteshin në historinë e demokracisë moderne për të gjithë popujt, që pikërisht tek imagjinari i barazisë dhe lirisë gjetën lëmën e përbashkët ku të kultivonin çdo nismë emancipuese, çliruese dhe kushtetuese, pavarësisht kufizimit të mëtejshëm që universalizmi revolucionar i ditëve të para pësoi, duke u shndërruar në ligjërim kombëtar e duke u trashëguar kësisoj në historinë europiane. Por edukimi i parë ndaj *citoyenneté*/ qytetësisë akoma përpara se shtetësisë që sot kemi trashëguar, mbetet ende një pikë referimi për shtysat demokratike dhe pjesëmarrëse që dolën në pah në vitet e para të Revolucionit Francez dhe në valat e mëtejshme të kërkesës për liri dhe barazi gjatë shek. XIX. Sepse pikërisht pjesëmarrja, hyrja e qytetarit në sferën publike dhe aktivizmi politik trashëguan nocionin e sotëm të politikës si pluralitet; ndaj nëse politika nuk është plurale, politikë nuk është. Një pluralitet që as vetë aktorët e parë të formës moderne të politikës nuk kishin hamendësuar, mjafton të përmendet nisma e parë - lindur si një kritike ndaj Deklaratës së 1789-ës, - e hartimit të një *Deklarate të së drejtave të gruas dhe qytetares*⁴, pararendëse

³ Pararendës për temën e të drejtave të njeriut është e mirënjohura Deklaratë e të drejtave e Virginia-s, 1779.

⁴ Déclaration des droits de la femme et de la citoyenne, publikuar ne shtator te 1791 nga shkrimtarja dhe aktivistja për të drejtat e

e çdo argumenti themelues të feminizmit modern⁵. Mjafton këtu të përmenden Olympe de Gouges apo Mary Wollstonecraft e më tej e bija Mary Shelley, autorja e krijesës së famshme Frankenstein. Kuptimi i lirive e të drejtave në të gjithë historinë europiane erdhi kështu si dhe i shformuar dhe i përkulur drejt lirive e të drejtave të burrit më tepër se të njerëzimit. Por mbetet e padyshimtë që, pavarësisht udhës që politika moderne mori gjatë fazave të ndryshme të Revolucionit francez, duke u shndërruar në një regjim që limitonte pikërisht pluralitetin, politika si fenomen nuk rreshti së provuari fiziologjinë

grave si dhe të skllëvërve nëpër kolonitë franceze, Olympe de Gouges. Konsiderohet si dokumenti i parë ku kërkohet barazia ligjore dhe juridike mes grave dhe burrave, duke vënë në dyshim autoritetin patriarkal.

⁵ Në historinë franceze dhe europiane Deklarata e famshme është lakuar me termin “homme”, “man”, “mensch”, burrit, mashkullit si përgjithësues i njerëzimit, derisa u transpozua në “droit de l’humanité, droits humaines”, të drejta të njerëzimit ose të njeriut. Zgjedhja semantike mbarte brenda një kufi gjinor akoma përpara se të diskutohej çështja e dhënies së shtetësisë/ citoyenneté/citizenship në terma veçimi mbi bazë census-i nga formulimet e para republikane pas rënies së monarkisë franceze, e cila nuk do të ishte më kurrë e njëjta monarki edhe pas Restaurimit. Por pavarësisht kësaj zgjidhje semantike, fakti i zbulimit të politikës dhe të pluralitetit fiziologjik që e përbën, dha shkëndijën në shumë hapësira, sidomos ato të shoqatave politike që shërbyen si katalizatorë aktivizmi për bazën e shoqërisë, parisienne fillimisht, që asnjëherë nuk ishte përfshirë në aktivizëm apo në rolin e aktorit politik. Pikërisht kjo shkëndijë krijoi një parantezë shumë interesante aktivizmi edhe nga ana e grave, që tentuan, fatkeqësisht pa sukses, të merrnin fjalën në agoranë publike, nëpërmjet përpjekjes për barazi politike, në një kohë kur pikërisht barazia ishte fjala kyçe e laboratorit revolucionar.

e saj plurale nga e cila ka lindur në çdo zhvillim të mëtejshëm të rrugëtimit të popujve për liri dhe *recognition*. Nevoja për një politikë të menduar si hapësirë lirie, theksohet jo më kot ende më fort e me ngulm nga Arendt pikërisht pas gjëmës së Holokaustit dhe mishërimit të totalitarizmave.

Nuk mund të mos jetë një ide, politika, sepse nuk mund të mos të jetë një botëkuptim, nuk mund të zhvishet nga thelbi i saj si bartëse e një sistemi vlerash, sikurse thekson znj. Leskaj, vlera që i japin kuptim dhe përmasa edhe vete konfliktit demokratik, si element fiziologjik i pluralitetit politik që aq jetim do të ishte pa kulturën demokratike për të cilët autorja, me përvojën e saj shumëvjeçare, mund të dëshmojë në lidhje me vitet e gjata drejt një modeli demokratik shqiptar. Një periudhë të cilën, ne, fëmijët e viteve Nëntëdhjetë u edukuam të quajmë “tranzicion”, një dispozitiv narrativ ky, i cili ka shërbyer shpesh si mburojë justifikuese e më pak si mjet analitik.

Publikimi i “Politika si ide” shqyrton, në saje të përvojës, reflektimeve, formimit, pasionit dhe përqasjes kritike të autores, fenomenet më të rëndësishme, ende aktuale, të gjendjes së politikës së gjerë dhe të tërësisë së institucioneve në Shqipëri. Përvojë e nisur si gazetarë, aktiviste e të drejtave të njeriut dhe drejtuese e shoqërisë civile, drejtuese e Qendrës për Popullsinë dhe Zhvillimin, për të vijuar

me pjesëmarrjen në qeveri dhe postin e deputetes apo Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, Kryesinë e grupit parlamentar të Partisë Socialiste dhe Nënkryesinë e Kuvendit të Shqipërisë, për të mos harruar praninë në dimensionin lokal të Shqipërisë dhe në kontekste institucionale ndërkombëtare në shumë vende të botës. Një sërë temash që ndërliidhen mes tyre për të krijuar një panoramë të karakteristikave dhe problematikave me të cilat jeta publike shqiptare përballet vazhdimisht, por që jep shkas gjithashtu për një thellim në modelin demokratik e sistemet politike përfaqësuese, në rang global.

Është interesante dhe shpresëdhënëse të lexosh në këtë libër që, ndryshe nga sa mund të duket nga një vështrim i jashtëm, arena publike e politike shqiptare në fazën e parë të formimit, ka pasur diskutime dhe subjekte që problematizonin rëndësinë e pluralitetit dhe të një kulture të ballafaqimit civil e të dialogut demokratik, me bindjen se cilado kundërvënie politike ka nevojë të mbështetet në një trashëgimi ideore të përbashkët, pikërisht si një hapësirë e përbashkët lirie.

Në shëndetin e një debati publik, edhe më publik sot se në vitet Nëntëdhjetë, rëndësi të veçantë ruajnë problematika si përgojimi publik, trillimi, dhuna verbale, tallja, ngacmimi dhe bullizmi kibernetik, që sheh një rritje të vazhdueshme, në deri 60% të

fëmijëve⁶, apo *public shaming*, shpesh konsideruar si një epidemi që po kthehet në një kulturë të turpërimit e të përbuzjes publike. Sikurse nënvizon autorja, shpesh kjo kulturë shfaqet në një nevojë kolektive për të “*shkatërruar po aq sa për të lartësuar me shpejtësinë e dritës*”, si në arenën politike po ashtu në megafonin mediatik. Dhe përgjegjësia për një klimë të tillë lidhet po aq me kë kryen bullizëm sa edhe me këdo kthen kokën nga ana tjetër. Sikurse problematizohet në shumë vende të botës ku ka dedikim ndaj kultivimit të kulturës demokratike në shoqëri, një dinamikë e tillë dëmton jo vetëm viktimat e abuzuara, por edhe vetë tabanin e përfshirjes dhe pjesëmarrjes në jetën sociale e politike të një shoqërie demokratike.

Dhuna verbale, përshpejtimi teknologjik që asimilohet në mënyrë johomogjene nga kategori e pjesë të ndryshme të shoqërisë, trajtat e populizmit dhe pasiguria në një horizont të ardhmërisë së përbashkët, i jep shpesh zë ekstremeve, por lë gjithashtu në hije një mazhorancë të heshtur. Sikurse nënvizon autorja, duhet gjetur një gramatikë politike aspak përjashtuese, që garanton ndeshjen dhe konfliktin, por pa skualifikuar dhe delegjitimuar pluralitetin. Sikurse pohuar në të gjitha rangjet politike e institucionale të vendeve me një retazh historik e kulturor demokratik, është shumë e

⁶ Sipas të dhënave <https://www.isigurt.al/> deri në 2019.

rëndësishme që kultura e pluralizmit të jetë farë në kultivimin e politikës. Për shkak të elementeve identitare në të cilët shpesh politika esencializohet, manifestohet shpesh risku i shndërrimit të politikës në ekuacionin schmittian “mik-armik”, ndonëse si kategori që shpjegon diversitetin ekzistencial nuk përfshin antagonizmin për arsye thjesht personale. Është një risk, ai i kundërvënies mik-armik që ka linfuar një pjesë të konsiderueshme të traditës politike perëndimore, deri në format më ekstreme të totalitarizmit, pogromeve apo degjenerimit gjenocidar.

Në një realitet ku rrjetet sociale bëhen gjithnjë e më të qëndrueshme, preokupimi i rregullimit të raportit mes njeriut dhe mjetit që ai përdor, natyrisht që po orienton një pjesë të madhe të studimeve të shumë fushave, shkencore e humaniste, përveçse të institucioneve që me një fenomen aq të ri sa edhe ndikues në stofën shoqërore po ndërmarrin një sërë masash për të mbrojtur individët nga abuzimet dhe shkeljet me origjinë kontekstin IT, dixhitalizimin dhe virtualizimin e marrëdhënieve; *EU Code of Conduct* është një ndër shembujt për kundërvënien ndaj *hate speech* në internet apo ndaj *fake news* dhe manipulimit të informimit. Por mbetet e patundshme bindja se një edukim i vazhdueshëm, që në brezat më të rinj, ndaj vlerave demokratike, ndaj historisë, ndaj lëvrimit të kujtesës dhe ndaj

principeve të një politike si hapësirë lirie e barazie, është baza për të luftuar çdo tentativë manipulimi informativ e politik.

Një nga elementet më interesante të librit është p.sh. përpjekja mjaft e artikuluar për një rindërtim historik të hapave të feminizmit shqiptar. Shembujt e jetës dhe angazhimit të Selfixhe Ciu, Ollga Plumbi, Musine Kokalari, Urani Rumbo, Mila Vangjeli, Motrat Qirjazi (f. 21-22), shtigjet që hapën në një kohë e vend ku krahas vargut të Çajupit⁷ vargu i Kanunit e shihte gruan si “shakull për të bajtur”, janë pjesë tepër të çmuara të kujtesës kolektive dhe si të tilla duhet të mbahen mend e të përfshihen së gjëri në tekstet shkollore.

Duke rikujtuar rëndësinë e shkrimeve të Selfixhe Ciu Broja, autorja sjell në vëmendje një kontekst tepër të vështirë për rolin dhe gjendjen e gruas në shoqërinë shqiptare të kohës: një sintezë që përmbledh gjithçka ishte gruaja në shoqëri po edhe në familje, një qenie pa zë (f. 21). Pikërisht atë zë që në mënyrë të vazhdueshme historia e gruas ka dashur të fitojë, në një sistem gjithëpërfshirës të ndërtuar nga ligjërimi patriarkal, sikurse theksonin gratë e 1789-ës e sikurse përpiqeshin e kërkonin gratë shqiptare, ku disa prej tyre zgjodhën nismën për arsimimin si rrugën më të mirë për fuqizimin e

⁷ “Burrat nën hije, lozin, kuvendojnë, pika që s’u bie, se nga gratë rojnë.”

grave dhe vajzave dhe për ndërtimin e një zëri për të drejtat e tyre.

Mesazh ende shumë aktual, që autorja thekson përgjatë gjithë librit ashtu sikurse ka theksuar gjatë gjithë karrierës profesionale e angazhimit të saj politik. Po aq fort sa thekson edhe rëndësinë e angazhimit të burrave në çështjen e barazisë së të drejtave të gruas, kur përmend "... Frashërlinjtë, që e kuptonin se shoqëria nuk mund të ecte përpara, nëse gjysma e saj është e shtypur dhe e prapambetur". (f. 23).

Si intelektualë e angazhuar, Ollga Plumbi, "nga të rrallat gra gazetare të viteve 1930, gruaja antifashiste, ish-presidentja e parë e Grave të Shqipërisë pas çlirimit të vendit, post që nuk i zgjati shumë, ashtu si për shumë intelektualë të tjerë, që nuk e patën të lehtë ose nuk pranuan të konformoheshin me çfarë po ndodhte atë kohë, [...] kishte bërë emër qysh në vitet '30 e më pas, kur u bë ndër të parat gra që u rreshtuan krah burrave në luftën antifashiste për çlirimin e vendit" (f. 26). Çlirimi i vendit bashkë me çlirimin e gruas, por ishte një ëndërr që nuk zgjati shumë, duke konsideruar zhvillimet e mëtejshme të jetës së Ollgës, sjellë në mënyrë të artikuluar dhe të apasionuar nga autorja, që Ollgën e ka takuar: "[Ollga, zëri i të pazëshmëve lënë në harresë] jetonte në rrugën e Kavajës, mbuluar nga heshtje. Kuptohej që shfaqjen e saj në publik e bënin të

vështirë kufizimet e kohës. Ishte një arsye madhore, që e bëri të mbyllë gojën e të lërë penën, gruan që dikur kishte sfiduar kohën” (f. 30).

Leskaj thotë se përpara rënies së perdes së hekurt, por në të vërtetë edhe pas rënies së saj: “[...] një pjesë e mirë e shoqërisë sonë feminizmin si koncept e konsideronte më tepër si shfaqje kapitaliste, si një deviancë borgjeze, madje edhe armiqësore, dhe jo vetëm në Shqipëri [...]. Gratë ashtu si edhe burrat, kanë vuajtur gjithë pasojat e një regjimi që prodhonte kufizime dhe shkelje të mëdha në të drejtat njerëzore, pavarësisht nga gjinia. Ajo që u shpall si emancipim i gruas, si orientim politik dhe krijimi i një kuadri ligjor, që garantonte të drejta të grave, pa dyshim që hapën rrugën për një sërë ndryshimesh në jetën e gruas. Qysh në fillim mbledhja e Këshillit të Dytë Antifashist, në nëntor 1944, sanksionoi të drejtat e barabarta të grave me burrat [...] dhe më pas këto të drejta u sanksionuan edhe në Kushtetutën e parë të Shqipërisë: ‘Gruaja është njësoj me burrin në çdo fushë të jetës private, politike e shoqërore’. Natyrisht, jo të gjitha gjërat kanë funksionuar si në letër; gjithsesi duhet thënë se arsimimi dhe punësimi; krijimi i një kuadri ligjor mbështetës; puna e bërë për çrrënjosjen e patriarkalizmit dhe veprimet të kanunit; disa të drejta si ajo e divorcit, e marrëdhënieve të pronësisë në çift, zgjatja e lejes së paslindjes për gratë nga 45 ditë në një vit, përfshirë

edhe të drejtën e babait për ta marrë këtë leje, krijimi i disa kushteve lehtësuese për gratë si kopshtet, çerdhet, konsultoret e nënës dhe fëmijës në çdo fshat etj., pa dyshim që ishin elemente të rëndësishme në çlirimin e gruas. Këto i konsideroj si gjëra shumë të rëndësishme për të drejtat e grave.

Thënë këtë, nuk mund të themi se gratë në kohën e komunizmit arritën të drejtat njerëzore në kuptimin dhe vlerën që marrin ato në një shoqëri demokratike e që lidhen me lirinë e shprehjes, lirinë e besimit, të pronës, edhe pse kjo e fundit në letër ishte e zgjidhur, lirinë e lëvizjes apo të drejtën e asaj që quhet 'choice' ose të drejtën për të vendosur në çift për fëmijët etj. [...]. Gratë në Kuvend ishin 33 %, kjo ishte pa dyshim një arritje, sidomos në kushtet e atëhershme dhe e vërteta është se 33 % është një shifër që nuk e kemi realizuar ende edhe sot pas 28 vjetësh demokraci, me gjithë ligjet dhe kuotat që kemi bërë, por përqindja e lartë e përfaqësimit, nuk ka ndonjë vlerë të madhe kur fuqia vendimmarrëse është pothuaj zero [...]. Kuvendi ishte thjesht noterizues i asaj çfarë vendoste partia.

Po them se punësimi [dhe arsimi i popullsisë] ishte vërtet një arritje, dalja e gruas nga shtëpia, megjithëse për këtë ka mendime të ndryshme, kujtoj vitet e para të ndryshimeve demokratike kur kishte jo vetëm burra po edhe gra, madje edhe politikanë që thoshin se kthimi i gruas në shtëpi është një arritje e demokracisë, personalisht nuk mendoj kështu dhe

jam e bindur që gratë në shumicë besojnë se jeta në komunitet pa dyshim që solli dhe më shumë liri e një jetë më sociale për gratë, brenda kufizimeve të kohës” (f. 75-76).

Dhe ende mbetet thelbësore tema e barazisë së të drejtave, jo thjesht në letër por mbi të gjitha në kulturën e një shoqërie e të një epoke që duket se ende mban përmbushjen e kuotave rozë si standard primar barazie, duke mënjanuar problemet strukturale të penalizimit të pjesëmarrjes së gruas në realizimin e potencialit shoqëror. Angazhimi i femrës në mbarëvajtjen e familjes dhe të shtëpisë, nuk konsiderohej dhe ende nuk konsiderohet mirëfilli si *labor*, pavarësisht insistimit të një pjese të feminizmit duke filluar nga vitet Shtatëdhjetë në përfshirjen e kësaj përgjegjësie, që kryesisht bie mbi shpatullat e grave, në kategorinë e punës së papaguar nga shoqëria, pra si pasojë një ndër format e shfrytëzimit mbi të cilin vetë sistemi ekonomik mbështetet.

Por, në një anë të botës, barazia thuajse e parajstë që sistemi komunist parashtronte, përkthehej në një dyfishim të përgjegjësive të femrës në shoqëri, punë e shtëpi bëheshin urdhëresë kategorike që, ama, nuk ribarazonin ekuilibrin e roleve gjinore dhe nuk shkëputnin rolin gjinor nga ai biologjik. Ashtu sikurse nuk vinin në dyshim radikal traditën tërësisht moderne dhe njëkohësisht arkaike të kufizimit të

përgjegjësisë së gruas në sferën domestike, sferë në të cilën impenjimi i saj nuk konsiderohej *labour* por përgjegjësi, duke trashëguar kështu në këtë traditë që ka strukturuar historinë perëndimore që prej fundshekullit të tetëmbëdhjetë, pabarazitë gjinore së bashku me pabarazitë e tjera të sistemit.

Ky shumëfishim i përgjegjësiave të gruas (në mungesë të një rishpërndarje të roleve sociale), shpesh u jepte argument pikërisht një sërë akuzave që një pjesë e së djathtës konservatore në USA e viteve Shtatëdhjetë akuzonte arbitrarisht feministet radikale apo reformatore, për *agenda-n* e tyre “djallëzore”, sipas së cilës këto të fundit kishin objektiv të shtynin femrat drejt një jete jo familjare, një jetë pa tutelën e rolit të nënës, një jetë në fabrikë e në stërmundim si pasojë e barazisë ligjore në vendet e punës, të vendosnin shërbimin ushtarak të detyruar për gratë, të shndërronin gruan në një individ më të shfrytëzueshëm dhe burrin, në një individ pa detyrimin ligjor e shoqëror për “ta mbajtur” atë. Phyllis Schlafly dhe kundërvënia e saj dhe e grupimit politik “Eagle Forum”, por edhe të grupimeve “New Right”, ndaj *Equal Rights Amendment* në fund të viteve Shtatëdhjetë, natyrisht nuk perfaqësonte të gjithë spektrin e republikanëve, ndër të cilët e të cilat, ka pasur subjekte të angazhuar në aprovimin e kurrëarritur të ERA.

Në kundërshti të plotë me feminizmin e Betty Friedan, Shirley Chisholm apo Gloria Steinem, Schlafly hipotizonte, polemikisht, pikërisht këtë shtysë asgjësuese për gruan si femër: shoqëria, sipas saj, nuk duhet të kishte detyrimin e të financuarit një shtet asistencial për të ndihmuar gratë që duke zgjedhur punësimin, linin fëmijët pa përkujdesje prindërore. Imperativi primar e më përmbushës për një grua duhet të ishte ai biologjik, të qenit nënë, së bashku me imperativin kulturor e ekonomik të të qenët grua e një burri; vetëm në mënyrë residuale, një femër mund të kishte “edhe” interesa të tjera jashtë sferës domestike. “Pse duhet të bëj dy punë, nënë e nëpunëse, nëse mund të bëj vetëm mëmësinë, pa pasur ‘nevojë’ të punojë në zyrë as edhe një ditë”, theksonte shpesh Schlafly. Ndonëse mund të tingëllojë anakronike edhe për periudhën në të cilën shqiptohej kjo frazë dhe megjithëse nuk ka qenë kundërvënia e Schlafly elementi kryesor e i vetëm për mosmiratimin e ERA, mbetet emblematike sesi termat e diskutimit mbi rolin dhe identitetin e gruas, si nga njëra anë e globit në tjetrin janë të lidhura me trashëgiminë e përbashkët patriarkale që lidh aq fort rolin biologjik të femrës me rolin e saj shoqëror e politik si grua e si njeri.

Një trashëgimi shumë e vështirë për t’u sublimuar, duke konsideruar sistematicitetin me të cilin operon e që aq shumë është studiuar e që së fundmi, me krizën e shkaktuar nga pandemia

prej COVID-19⁸ dhe masat emergjenciale, ka dalë rrëmbyeshëm në pah me shifra konkrete që tregojnë si dhe sa gratë janë pre e një sistemi ekonomik ku roli i tyre në tregun e punësimit është tërësisht i pabarabartë dhe menjëherë i sakrifkueshëm. Silvia Federici, sociologe, filozofe, akademike në studime gjinore si dhe aktiviste mjaft e njohur ka shkruar mjaft gjerë mbi një analizë të tillë, mbi rëndësinë e “*reproductive labour*” apo realitetin e fenomenit që Arlie Hochschild në 1989 quante “turni i dytë” e që sot bëhen ende më të dukshme dhe të prekshme¹. Natyrisht, nuk mund të bëhen politika të mira nëse një prej sektorëve më të mëdhenj të ekonomisë së vendit braktiset në hije, një sektor që kriza aktuale vuri në rend të ditës në mënyrë urgjente, si p.sh. diskutimi mbi “punëtorët/sektorët esencialë”. Në mënyrë spekulare, edhe Ivan Krastev nënvizon brishtësinë dhe dështimin e Bashkimit European më tepër sesa suksesin e tij në përballjen me krizën e pandemisë, pasi për “paradoks, pikërisht kjo krizë u ka treguar qeverive Europiane se një rritje

⁸ The Lockdown Showed How the Economy Exploits Women. She Already Knew. Silvia Federici has been warning for decades of what happens when we undervalue domestic labor, nga Jordan Kisner në «The New York Times Magazine», shkurt 2021. Shiko <https://www.nytimes.com/2021/02/17/magazine/waged-house-work.html> Gjithashtu, https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/id_development_cooperation_fundamental_rights/annual_report_ge_2021_en.pdf

e integritetit të brendshëm duhet të marrë një hov të ri përkundër niveleve të globalizimit; pandemia ka sjellë më tepër kozmopolitizëm në botë dhe një tendencë për një tkurrje të globalizimit”⁹.

Sikurse pohon Valentina Leskaj, *“pabarazia gjinore përbën një pengesë serioze për uljen e varfërisë dhe për zhvillim të qëndrueshëm. Nuk ka zhvillim të qëndrueshëm të një vendi pa integritetin e grave në proces dhe nuk ka zgjidhje të problemit gjinor pa një zhvillim të qëndrueshëm. [...] Kur familja është e varfër gruaja është dyfish e varfër; edhe pse ajo ishte dhe mbetet personi që administron [...] gjërat bazë për cilësinë e jetës. [...] Por po ashtu gratë janë kategoria më e predispozuar për të rënë në kurthin e varfërisë dhe një nga problemet që e bën jo shumë të dukshme në agjendat, që adresojnë probleme të zhvillimit njerëzor në Shqipëri”* (f. 76).

Është shprehur mrekullisht nga çmimi “Nobel për Ekonominë” më 1998, Amartya Sen, se varfëria nuk është thjesht mungesa e të ardhurave dhe burimeve ekonomike, por edhe mungesa e mundësisë për të realizuar dëshirat, pra mungesa e lirisë për të vendosur mbi jetën tonë. Nuk mund të ishte më i qartë ky princip në praktikën e mikrokredisë së krijuar nga Muhammad Yunus,

⁹ <https://www.maastrichtuniversity.nl/events/studium-generale-europe-after-pandemic>

çmim “Nobel për Paqen” në 2006, nismë që sikurse njihet i ka ardhur në ndihmë punës dhe aftësive sipërmarrëse të shumë grave, fillimisht në zonën Jobra te Bangladeshit, ku nga takimi dhe njohja me problematikat ekonomike e financiare të një vajze 21 vjeçare, Sufiya Begun, lindi një prej eksperimenteve më të suksesshme të financimit të mikrokredive, mjet që i vjen në ndihmë jo thjesht më të varfërve por të gjithë atyre që janë përgjithësisht të mënjanuar nga qarku bankar tradicional duke mbetur vazhdimisht nën kthetrën e borxhit, dhe si pasojë të destinuar në qarkun vicioz të varfërisë dhe të pamundësisë për të realizuar resurset e aftësisë dhe *capabilities*¹⁰ si individë dhe si komunitet. Jo rastësisht, gratë kanë qenë element bazë dhe histori suksesi në zhvillimin e këtij mjeti, pikërisht sepse jo vetëm janë ende kategori më pak e pajisur me mjete për të mos rënë në kurthin e varfërisë por edhe sepse nuk mund të mënjanohen çështjet e

¹⁰ Capability approach, përkufizuar fillimisht në vitet Tetëdhjetë dhe përcaktuar gjerësisht nga autorë si Amartya Sen dhe Martha Nussbaum, lind si alternativë e ideve tradicionale mbi ekonominë e mirëqenies duke u nisur nga principi se jo thjesht e drejta dhe liria për të arritur mirëqenien, por mbi të gjitha mundësia konkrete për ta realizuar atë, është thelbësore në zhvillimin e mirëqenies njerëzore. Për një bibliografi të detajuar, shiko Robeyns, Ingrid and Morten Fibieger Byskov, “The Capability Approach”, The Stanford Encyclopedia of Philosophy (Winter 2020 Edition), Edward N. Zalta (ed.), <https://plato.stanford.edu/archives/win2020/entries/capability-approach/>

grave nga strategjia e zhvillimit të një shoqërie të shëndetshme.

Një tjetër faktor i përvojës dhe tematikës që autorja përshkruan, është edhe aktivizmi politik, një arenë gjithnjë e më e artikuluar globalisht, mjafton të mendojmë për kërkesat që nuk rreshtin së përqasuri opinionin publik botëror mbi tema e çështje të feminizmit interseksional - *all oppression is connected* - mbi problematikat e të gjithë spektrit gjinor dhe të orientimit seksual, mbi kujtesën kolektive dhe dekolonializimin, racizmin strukturor, integrimin, çështjet e identitetit, etj.

Për sa i përket Shqipërisë, autorja thekson karakteristikat dhe dallimet mes aktivizmit të shoqërisë civile shqiptare në vitet Nëntëdhjetë, përkundër tendencës më tepër *donor driven* të viteve pasuese, duke vënë në pah një anë tepër të rëndësishme të mënyrës se si është strukturuar rrjeti i shoqërisë civile shqiptare. Nëse do të shtonim në këtë kontekst edhe një digresion rreth gjendjes së institucioneve e jetës publike në lidhje me fenomenin e korrupsionit, literatura do të zgjerohej në kohë dhe hapësirë, duke konsideruar raportet dhe studimet që vazhdimisht lëvrohen mbi çështjen e kapjes së shtetit, interesat e asistencës ndërkombëtare dhe interesat e donatorëve në 30 vitet e fundit në të gjithë Ballkanin perëndimor¹¹.

¹¹ Will Bartlett, International assistance, donor interests, and